Kronikë

Tiranë/ Në hetim prej 3 muajsh, goditet grupi i trafikut të armëve! 2 në pranga, 2 në kërkim, sekuestrohen armë e municione! Një kallashnikov shitej 1000-1500 euro (EMRAT+VIDEO)

Policia e Tiranës goditi një grup që shisnin armë në kryeqytet dhe në Fushë-Krujë. 2 persona nga Laçi u vunë në pranga teksa e kishin mbushur makinën me armë gati për t'i shitur. Armët, kallashnikovë dhe pistoleta do të ekzaminohen për të parë nëse janë përdorur në ngjarje kriminale.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
21 Shkurt, 10:45 | Përditesimi: 21 Shkurt, 15:14

Share

TIRANË - Fatjon Kodra 18 vjeç dhe Elton Kaci 49 vjeç, banues në Tiranë, por me origjinë nga Laçi, ishin gati të shinin disa armë zjarri, të cilat i kishin fshehur në automjetin me të cilin udhëtonin. Efekte

Por efektivët e policisë, të cilët i ishin vënë në ndjekje prej disa kohës, i kapën në befasi, duke i arrestuar. Efekte Grupit iu sekuestruan 3 kallashnikovë, 2 pistoleta e municion luftarak, të cilat dyshohet se do të shiteshin në Tiranë Fushë Krujë dhe në Thumanë. Efekte

2 pjesëtarë të tjerë të grupit, Florian Aliu dhe Enea Zira 28-vjeçarë, u shpallën në kërkim ndërsa hetimet për të dokumentuar veprimtarinë e plotë kriminale të këtij rrjeti të trafikut të armëve, vijojnë nga Prokuroria e Tiranës.

LEXO EDHE:
Superiorja/ Humbja me Bylisin i kushton shtrenjtë, Partizani shkarkon trajnerin serb Veselinoviç! Shkak rezultatet e dobëta, pritet tekniku i ri

Aggjentët kishin më shumë se 3 muaj që vëzhgonin grupin. Një prej tyre ka bërë dhe blerje të simuluar, duke marrë si klient armë te ky grup. Një kallashnikov, sipas burimeve, kushtonte nga 1 mijë deri në 1500 euro, ndërsa pistoletat nga 1500 deri në 2 mijë euro. Efekte

Armët e zjarrit rezultojnë të jenë të vjetra. Të gjitha do të dërgohen për ekzaminim nëse janë përdorur për ngjarje të tjera kriminale.

> *'Seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën Operacionale të DVP Tiranë, në drejtimin e Prokurorisë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor "Heliks", si rezultat i të cilit u ndaluan shtetasit:*
>
> *Fatjon Kodra, 18 vjeç dhe Elton Kaci, 49 vjeç, banues në Tiranë. Gjithashtu u shpallën në kërkim shtetasit Florjan Aliu, 28 vjeç dhe Enea Zira, 28 vjeç. Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas, të organizuar si grup, shitnin armë zjarri në Tiranë, në Fushë Krujë dhe në Thumanë.', njofton policia*

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Tiranë fushë krujë Thumanë trafik armesh Fatjon Kodra Florjan Aliu Enea Zira Elton Kaci

Komento

Komente

Xcvhjjj: 21/02/2025 14:01

Tua fusi ne prapanic armet shteti ketyre horrave te laçit ..trageti te ndyr qe bejn

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 20 Shkurt, 10:37
Primaret në PD, a mendoni se do të jetë një proces i drejtë?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

KKTU miraton disa leje për kulla, hotele, rrugë dhe planin për 'Durana Tech Park' (LISTA)
21 Shkurt, 20:09

Del foto e shqiptarit me dy emra që u arrestua në Tiranë për ekstradim! Për çdo ngarkesë që vinte në Europë, trafikonte 30 kg kokainë në Itali
21 Shkurt, 19:33

Veliaj nga qelia ndan dokumentarin për transformimin e kryeqytetit: Lufta për Tiranën Europiane nuk ndalet
21 Shkurt, 19:14

Inaugurimi i Pediatrisë së Përgjithshme, Rama: Pagat e mjekëve do vijojnë të rriten! Buxhet rekord për shëndetësinë deri 1 mld euro
21 Shkurt, 14:27

'Qeveria të na shpëtojë nga llumi i zi', banorët pranë lumit Ishëm kërkojnë pastrimin e plehrave! Masterplani i Mjedisit mbetet në letër

Julian Shota

21 Shkurt, 14:21

Kryetarja e Kuvendit, Spiropali pret Sekretarin e KiE-së, Alain Berset: Mbështetje për Shqipërinë në sundimin e ligjit!
21 Shkurt, 13:28

Tiranë/ Alarm i rremë për bombë në kolegjin "Turgut Ozal", krimi kibernetik heton kush fshihet pas e-mailit alarmues
21 Shkurt, 13:13

RENEA arreston Safet Bajrin, masë sigurie edhe për krahun e djathtë, Astmer Bilali e kushëririn Behar Bajri! SPAK: Ekzekutuan Fatbardh Licin në 2018, morën hak për vrasjen e ish-policit Bërçana (VIDEO)

Sokol Dema

21 Shkurt, 12:46

'Mbështes SPAK, por diçka nuk shkon', Petro Koçi: Nuk mund të ketë kontroll mbi partitë politike! Republika jonë është parlamentare, nuk e luan topi!
21 Shkurt, 12:34

'Bën propagandë dhe nuk ke asnjë meritë', Rama i përgjigjet komentuesit në 'Sy m'Sy': Ngrita Tiranën nga varri! Kur e mori 'Këneta' me dhunë nuk punonte as Sahati (VIDEO)
21 Shkurt, 11:47

Shtyhet seanca gjyqësore në GJKKO për inceneratorin e Tiranës, shkak mungesa e një prej avokatëve mbrojtës
21 Shkurt, 10:31

Tenderat kur ishte drejtor i ARRSH-së/ Dashamir Xhika, anëtari i kryesisë së Partisë së Lirisë në SPAK për 1 orë e 40 minuta (VIDEO)
21 Shkurt, 09:56

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje